Si detyrë kryesore që dubet me e zgjidhë në tanësi Bashkimi, asht çash ja e studjimit të çdo forme e mënyre për t'i a dhë në ndihmë nalltësimit kulturat të masës shqiptare, mbassi format e derlutshme nuk k-në dhanë rezultate të mjaftueshme në këtë pikpamje. Tue u-mbështetë ne këto dhe për të mujetë me i krye ma lehtë këto detyrë, na do të fillojmë me themelue shoqni të veçanta kulturo-arsimore e kulturo artistike për shqiptarë në gjuh e Bashkimit, prandaj asht e nevojshme që çdo shqiptar që e don kulturën e popullin e vet ta ndijë si detyrë të veten me kontribue rreth kësaj pune.

Ne sot krijojmë Jugosllavin e re me strukturë të re shoqnore dhe ekonomike, krijojmë shoqnin socialiste, e cila kulturë nder-kombëtare — siç e kanë thanë shpesh herë udhëheqësit t'one — nuk e mohon asjnk atë nacjonale, por përkundrazi zhvillimin i traditave pozitive të së kaluemes së lavdieshme e perfocon kulturen soc aliste iden e internac onalizmë-s. Popujt t'onë kanë nji të kaluemë të shkelqyeshme e, si t'omos të kaluemen e fërme. Bash imit i takon që t'i edukojë me frymen e ke yne traditave turmat e popu lit dhe brezin e ri.

Mbas referatit dhe diskusjonit u-zgjodh kryesija e Bashkimit me tho ët që viloj e: kryetar Xhafer Vokshi nën kryetar i I-rë Rako Vukqeviq nën-kryetar II të Kadi i Reufi, sekretari I-rë Ymer Pula e sekretari i II-të Millutin Mil losheviq.

Gjakovë : Mitingu i perfundimit të fushates s' analfabetizmit

N'arsimin populluer jane korre suksese te kenaqshme

Me rezultate jo te plota, ne Krahinen t'one mbrenda kater muejve kane mesue te shkruejne e te kendojne 36,296 analfabet

Si në çdo sektor ashtu dhe në lamen e arsimit populluer janë korrë suksese të dukshme.Mbrenda perjudhës së luftimit t'analfabetizmit -prej nandorit 1947 deri me 15 mars të këtij viti-asht punue e mësue sistematikisht nder kurset analfabetike të Krahines s'onë. Me gjithë vështirsinat e ndryshme dhe mungesen e kuadrave t'aftë udhëheqëse të kurseve, prap se prap me ato forca që kishim e plotsuem planin, në saje të ndihmës dhe të organiz-mit të punës me plan prej organizatave të Frontit p-

Formimi i shoqnis Kulturo-artistike në Gjakovë

Me inisjativen e puntorëve arsimorë të qytetit të Gjakoves, e në lidhje me garat e Nji Maji, para disa ditve asht formue në Gjakovë shoqnija kulturo-artistike „Koha e re".

Në këtë shoqni janë regjistrue ma se 60 shqiptarë, serbë e ma lazezë dhe janë formue seksjonet dramatike, kori, seksjoni i muzikes, i folklorit dhe seksjoni i shahut.

pulluer dhe të vullnetit të mirë e koshjences s'udhëheqësave e udhëheqëseve të kurseve. Në luftimin e analfabetizmit jo vetem që kanë kontribue arsimtarët, antarët e Frontit, të rjitë e të rejat, por kanë kontribue edhe pionerët e pioneret e vegjël. Në shum rrethe, sidomos nëpër katunda, pioneret e kanë plotsue planin 100 %, d. m. th. i kanë aftësue të gjithë ndjekësit e kurseve të mëso,në me shkrue e me kendue.

E gjithë kjo punë asht vertetue dhe po vertetohet vazhdimisht -me rastin e provimeve, me gjithë që kanë qenë mjaft rigoroze -e po plotsohet plani 100 %. Me këtë kuptohet kjarte se si vullneti i udhëheqësave ashtu dhe ai i kursistave kanë ba të realizohen qellimet e tyne dhe njikohsisht të realizohet nji pjesë e mirë e vitit të dytë të Planit pesvjeçar.

Me gjithë që ende nuk kanë marrë fund provimet krejtësisht, me rezultatet e deritashme kanë mesue të shkruejnë në Krahinen t'onë 36,236 analfabetë, prej të cilëve 15.520 femna; prej këtyne shqiptarë e shqiptare 23,030. Tue marrë parasyshë se në vazhdimin e provimeve do të fitojë me siguri dhe nji përqindje e mirë, sigurisht, plani do të plotsohet e bile edhe mued të tejkalohet në tanësi.

Sukses i dukshëm asht dallue edhe nder kurset arsimore, ku kursistat kanë fitue njohuni fillestare nder landët ma kryesore të mësimeve.

Interesim i veçantë për mësim asht dallue edhe nder puntorët e minjerave, ndermarrjeve dhe sipërmarrjeve të ndrysh me, të cilet për pos punës fizike i kanë kushtue kujdes të madh edhe punës mendore-mësimit. Me qinda e qinda punto ë që deri dje s'kan- dijtë se si mbahet lapsi, sot dijnë të shkruejnë e të kendojnë e bile edhe të lexojnë libra me brum bukur të vështirë.

Nga të gjitha këto jepet me kuptue se prej sukseseve të korruna do të sitohen edhe ma fort fuqit e popujve t'one, vullneti dhe vetmohimi në punë, kushte të cilat kanë me ba që ata t'i kryejnë të gjitha detyrët që ua ka parashtrue Plani pesvjeçar.

Burrat dhe gratë shqiptare në miting mbas kryemjes me sukses te kurseve analfabetike

K.V. Ostrovitjanov

Sistemi i garavet socjaliste si faktor ne ngritjen e fuqive prodhuese te shoqnis sovjetike

Faktori ma i randesishmi i zhvillimit të fuqive prodhuese në stadjumin e socjalizmit asht sistemi i garavet socjaliste dhe forma e tij ma e naltë-divizja stahanovjste.

Kapitalizmi nuk krijon terrene për kurrfarë lëvizjeje masovike të puntorëvet, e cila të synojë ngritjen e produktivitetit të punës. Përkundrazi, nën kushtet e kapitalizmit, puntori asht i shtrënguem të zhvillojë luftë të papreme kundra sistemesh të ndryshme racjonalizimi kapitalist, që kanë për qëllim t'a çfryetësojne edhe ma keq fuqin e tij.

Sistemi sovjetik, marrëdhanjet socjaliste të prodhimit lindin qëndrimin e ri ndaj punës, qëndrim i panjohtun para formacjonevet socjaliste.

Në fillim të kalindorit të vitit 1918, fillë mbas fitores së Revolucjonit të Madh Socjalist të Tetorit, Lenjini shkroi artikullin: „Si t'organizohet sistemi i garavet?", në të cilin e hodhi poshtë pozitën, që e përhapeshin atunjet e socjalizmit, se kinse socjalizmi e mbyt çdo inisjativë, e shqymë çdo garë». Socjalizmi—thotë Lenjini,—jo vetëm qe nuk e shqymë garën, por përkundrazi, për të parën herë, krijon mundësin që ajo të zhvillohet me të vërtetë gjanësisht, me të vërtetë në përpjestime masovike, që me të vërtetë të hyjnë shumica e njerëzve punonjës n'arenen e nji pune asisoji, ku të mund t'a tregojnë vehten, t'i zhvillojnë aftësit e veta të mund të zbulohen talentet që gjinden plot e plot në popull e që kapitalizmi i ka ndrydhë, shtypë e ua ka zanë frymen mija e miljonavet njesh.

Lenjini ka tregue ndryshimin, ndrysh.m si nata me ditën-në mes të konkurrences kapitaliste dhe sistemit të garavet socjaliste.

„Hyperizmi i marrëdhanjeve kapitaliste të prodhimit, përmbysja e kapitalizmit-ka shkrue Lenjini-krijon mundësin që sistemi i garavet në vend të formave të tija mi more, t'organizohet në forma njerëzore.

Në bazën e konkurences qëndron ligji antinjerzor i luftes së disave kundra tjerëve, ligji i fitimit të nji pale në saje të rrenimit të të tjerëvet.

Në bazë të sistemit të garavet socjaliste qëndron parimi i bashkpunimit shoqnuer dhe ndihmës reciproke socjaliste.

Sistemi i garavet socjaliste materijalisht i kushtohet direkt karakterit shoqnuer të punës në shoqnin socjaliste dhe parimit socjalist të shpërblimit simbas punës.

Shoku Stalin ka thekësue se ndrrimet e karakterit të punës shoqnore në stadjumin e socjalizmit-ndrrime të cilat janë rezultat i mundimit të pronësimit shoqnuer mbi mjetet e prodhimit,-janë ngja nga arsyenat ma të randësishmet qe e kane perfuc levizjen sta hanovatore.

Ke na thot shoku Stalin—njere ait nuk punojnë për çfryetësimesa nuk punojnë që t'i pasunojnë pasanitët, por për vehte, për klasen e vet, për shoqnin e vet, sovjetike, ku janë në pushtet njerëzit ma të mirë të klasës punture. Prandaj ke na puna ka karakter shoqnuer, ajo asht çashtje nderi dhe lavdije. Në kapitalizëm puna ka karakter privat, personal".

Parimi socjalist i shpërblimit në bazë të sasis dhe cilësis së punës ban që puntori të jetë materjalisht i interesuem me e ngritë intenzivitetin e punës së vet, me të cilën inisjativen e tij krijuese për çpkje, për racjonalizimin e procesit të prodhimit dhe pikërisht për këtë asht nji faktor i fuqishëm për zhvillimin e sistemit të garavet socjaliste dhe formës së tij ma të naltë—lëvizjes stahanovjste.

Sistemi i garavet socjaliste asht njena prej fuqive kryesore për ngritjen e prodhimit socjalist. Ay ka luejtë një rol me shum randësi në zhvillimin e prodhimit socjalist, si n'industri ashtu edhe në bujqësi, dhe ka qenë një nga faktorët vendimtarë në përmbysjen dhe tejkalimin e Pjatiletkave Stalinjane.

Sistemi i garavet socjaliste dhe levizja stahanoviste mueren bov të pashembullt gjatë kohës së luftës në madhe Patriotike. Sistemi i garavet socjaliste u-zhvillue në mbarë BRSS. U-zhvillue gjanësisht inisjativa e popullit nder fabrika, stabilimente e kolhoze. Njerëzit Sovjetikë—puntorët, kolhozjanët dhe inteligjenca — pumen me vetmohim për nevojët e frontit dhe kryen gjeste heroike në punë, tue i kalue sa e sa herë planet e prodhimit, tue ngrehë n'afate çuditnisht të shkurta, fabrika, elektrocentrale, vija hekurudhore, kanale të reja etj. Njerëzit punonjes kanë paraqitë mija e mija proponime racjonalizimi, të cilat kanë ajedë ngritjen e produktivitetit të punes, kursimin e lendëve të para e materjalit. Në kët hov të fuqishëm të prodhimit socjalist, që shpërtheu gjatë luftës së madhe Patriotike, nji nga faktorët vendimtar ka qenë sistemi i garavet socjaliste.

Sistemi i garavet socjaliste fitohet të losë nji rol vendimtar edhe në përmbushjen e Pjatiletkës së re Stalinjane.

Ligji mbi Planin e ri Pesvjeçar asht pritë nga populli puntuer i BRSS me gjesto të reja ne punë. An' e mb'ane Vendit nder fabrika e mstatute, nder arat e sovhozevet, rritet dhe përhapet sistemi i garavet socjaliste, i cili në flamurin e vet mbane parullen: „Me i përmbushë dhe tejkalue detyrët e Pesvjeçorit të ri Stalinjan".

Zhvillimi i garavet socjaliste në mbarë BRSS-ajelë që rezultatet e Stahanovestavve ma të mirë të bahen jevnë e të gjithë popullit dhe asht edhe një faktor në ngritjen e prodhimit socjalist.

Rezultatet e garave te Nji Majit le te bahen nxitje per pune edhe ma te mdhaja ne lulezimin dhe lumnin e plote te Vendit t'one

Fronti popullues e kremton festen e Nji Majit me rezultate te dukshme ne performime e vet te mbrendeshem organizativ dhe ne perpjekjet e gjithaneshme per zhvillimin ekonomik dhe kultural te Krahines s'one.

Radhet e Frontit t'one Popullues jane zgjanue me pjesemarrjen e mija e mija antarve te rij dhe jane pastrue me hjedhjen jashte t'atyne pak elementave, qe nuk e duen te miren e populve t'one.

Fronti i jone popullues ka m... bilizue dhe organizue turma te mdhaja, te cilat, me punen vullnetare neper aksjonet e ndryshme, kane dhane nji ndihme te gmiueshme ne ngritjen e objekteve ekonomike te paraparame me Planin t'one pesvjecar, ne permbushjen e masave te ndermarruna nga qeverija e jone popullore per shpejtsimin e zhvillimit t'one dhe ngritjes se jetes ma te lumtun te popujvet t'one.

Fronti i jone popullues ka dhane nji kontribut te gmueshem ne luften kundra mbrapambetjes kulturale te masave popullore te Krahines s'one e sidomos te masave shqiptare: ne luften kundra analfabetizmit, ne aksionin per emancipimin e femnes muslimane shqiptare, ne permiresimin e kushteve hygjenike te jetes, ne zhvillimin e shtypit dhe botimeve, ne zhvillimin e levizjes artistike, fis-kulturale etj.

Ne lamen politike, Fronti i jone popullues ka ndihmue shum ne zhvillimin e ne ruejtjen e pastertis se pushtetit t'one popullor, ne demokratizimin e tij, ka perforcue edhe ma teper vllazninin dhe bashkimin ne mes te trija kombesive te Krahines s'one, vllazninin e bashkimin e shqiptarve me te gjithe popujt e tjere t'o,t dheut t'one. Ai i ka demaskue sistematikisht ata qe jane perpjekte me pengue punen e popujve t'one ne ndertimin e socjalist, d. m. th. ne ngritjen e ardhnenis se tyne ma te mire. Fronti i jone popullues ua ka spjegue masavet t'ona popullore manevrat e ndyeta te reaksionit nderkombetar, nitesave te luftes, me Imperjalizmin amerikan ne kryc; na ka spjegue shtresave t'ona te gjana popullore luften e kampit demokratik anti-imperjalist, me Bashkimin Sovjetik dhe shtetet e demokracia se re ne kryc, per paqe te qendrueshme e demokraci popullore si dhe rolin e atdheut t'one ne gjirin e ketij kampi. Dhe popujt t'one, ne saje t'organizates se tyne te pergjithshme politike popullore, Frontit Popullues, e kane kuptue se menyra ma e mira, rruga ma e pershtatshmja ne luften kundra reaksionit dhe manevrave te tij aasht puna e paladheshme per plotsimin e tejkalimin e Planit pesevjecar te Titos, d. m. th. per fuqizimin e gjithanesh shem t'atdheut t'one-Republikes Federative Popullore te Jugosllavis.

Kolektivi punonjes i „Trepças" po e feston diten nderkombetare te pergjithshme te punes — Nji Majin —, me krenarin ma te madhe, tue u-mburrë per fitoret e korruna ne realizimin dhe tejkalimin e detyreve te planit te prodhimit. Ky kolektiv, per heren e tretë, po e mban vendin e parë ne mes te kolektivave punonjes ma të mirë në mbarë Vendin t'onë, dhe po e çon naltë flamurin kalimtar të Këshillit Qendruer të Sindikatave t'Unjisueme. Tue i krye me nderë premtimet që ky kolektiv i ka dhanë Marshallit Tito dhe popujve të Vendit t'onë se do t'a tejkaloje planin e prodhit për 5%. gjatë, garave të Nji Majit kolektivi ka muejtë jo vetem me e plotsue, por edhe me e tejkalue këti obligim. Kolektivi punonjes i Trepçes me punen e deritashme vetmohuese ka muejt me ngritë nga gjiri i vet fuqi të reja punторesh të kualifikuem, shum salmuesa, novatorë e racjonalizatorë.

Vetem në kvartalin e parë të këtij vjeti ky kolektiv e ka realizue planin e prodhimit.

Plani i muejit prill asht realizue 8 diet para afatit me 108,61 %. Me daten 22 prill ka korrë fitoren ma të madhe te deritashme tue e realizue planin dituer me 136 %.

Nder pionert e parë të fitoreve të mdhaja të këtij kolektivi janë salmuesat e shumfishit si Osman Murati, Ramo Blishkovac, Shemsi Sulejmani e shum e shum të tjerë. Osmani asht minatori ma i mirë, 6 herë salmues e gjoksin e tij e zbukurojnë: Urdhni i jonë i punës i rendit III-të si dhe Urdhni Çekosllovak i punës. Rama asht salmues i shumfisht, punon për nji herë në dy kompresorë e tash asht tue kerkue menyren me punue me tre kompresorë. Shemsija asht ngarkuesi ma i mirë. Ky katundar i vobekët nga katundi Obranç i rrethit të Podujeves ka hy në minjerë në mbarimin e muejit maj 1947. Me punën e tij vetmohuese mbrenda 10 muejve ka mbrritë që të hyjë në rradhen e punorëvë ma të mirë dhe të deklahorohet tri here salmues. Ky ka mbrrijtë shpesh herë me e tejkalue normen gadi me 400%. —Kur erdha në minjerë tue me pa të dobët fizikisht e me trup të vogël, nuk dojshin me më pranue në punë, sado që unë premtojsha se do të punoj me të tana fuqitë dhe se do t'a tejkaloi normen. Kur me pranuen lypa punën ma te randë në tunel, për të cilen e ndiejsha vedin t'aftë. Qysh diten e parë e tejkalvia normen me 20 %. Kjo gja me trimol edhe ma teper due për çdo ditë mbrrijsha rezultate ma të mira. Po sa here në punë i vuna vedit për detyrë kryesore: t'i ndjekë gjurmat e minatorve salmuesa të Trepçes dhe të bahem edhe unë si ata. Dhe me të vertetë për nji kohë të shkurtë emni i Shemsiut iu ba i njoftun të gjithë punторve të Trepçes. Ky sot asht tue ndjekë kursin e minatorve dhe dallohet nder të gjithë. Ky punon haras me tre ngarkues të tjerë dhe e mbushë vagonin për dhetë minuta ndërsa të tre ngarkuesat tjerë së bashku mundin me e mbushë për li minuta. Shemsiu sot punon dhe e din sepse punon, por simbas punes që ban edhe shpërblehet, p. sh. ai vetem për nji muej ka marrë shpërblim ma se 18.000 dinarë. Ky punon për kolektivin por n'anën tjeter i jepen të gjitha mundësit si çdo njeriut punonjës të Vendit t'onë.

Lufta për realizimin e Planit pesvjecar asht ba simbol jete në zemrat e minatorëve të Trepçes. Me këta sot mburret kolektivi punonjës dhe mbarë populli i atdheut t'onë.

Kolektivi punonjës i „Trepças" po e mbane naltë flamurin kalimtar te Keshillit qendruer te Sindikatave te Jugosllavis

Fronti popullues i rrethit te Gjakoves fitoi flamurin kalimtar te Keshillit Krahinuer te Frontit popullues

Garat qe jane zhvillue ne mes t'organizatave te Frontit popullues te Krahines s'one jane dhane rezultate majt te mdhaja. Hovi punues dhe fryma e garave kane perfshi dite per dite antare te rij dhe shtresa te reja te masave te gjana popullore. Antaret ma te mire te Frontit popullues jane ba fluturuar te hovit punues dhe shembull per disipline dhe vetmohimin ne pune, e organizuara e Frontit, e marrun ne tanesi, asht ba faktor i randesishem ne luften per realizimin e Planit pesevjecar.

Nga rezultatet e fundit te garave shifet se organizatat e Frontit popullues jane perpjekte me te gjitha fuqit e veta qe ti realizojne e bile edhe t'i tejkalojne detyret e parapame ne plan.

Mbas shqyrtimit te rezultateve prej Keshillit te Frontit popullues Krahinuer, u-konstatue se Keshilli i Rrethit te Frontit Popullues te Gjakoves ka gorre suksese ma te mira nder te gjitha organizatat e rrethave te Krahines.

Prej Kallnorit te ketij vjeti deri tash organizatat e Frontit popullues te rrethit te Gjakoves kane dhane: ne sektorin e bujqesis dhe pyjeve 344180 ore pune vullnetare dhe 199946 ore pune me kafshe terhjekese me vlefte prej 4,576,010 dinaresh; ne lamen e ndertimeve 302334 ore pune vullnetare, 202984 ore pune me kafshe terhjekese me vlefte prej 5,269,760 dinaresh. Ne ket shume llogariten edhe ndihmat ne te holla qe jane mbledhe per ndertimin e shtepijave kooperative. Per permiresimin e rrugeve dhe qeljen e rrugeve te reja kane dhane 93730 ore pune vullnetare dhe 48125 ore pune me kafshe terhjekese me vlefte prej 714300 dinare. Per regullimin dhe hapjen e dyqaneve te reja jane dhane 6500 ore pune vullnetare me vlefte prej 35000 dinaresh. Per mprojtjen dhe sherbimin e shendetit te popullit jane dhane 32650 ore pune vullnetare dhe 123 ore pune me kafshe terhjekese, pune e cila llogaritet ne 46700 dinare. Ne sektorin e kujdesimit shoqnuer jane dhane ndihma n'artikuj te ndryshem me nji vlefte prej 20,362,50 dinaresh. Per qeljen e lulishtes se re jane dhane 18500 ore pune vullnetare dhe 3456 ore pune me kafshe terhjekese me nji vlefte prej 288,000 dinaresh.

Per aksjone tjera te ndryshme jane dhane ndihma ne te holl, dhe asht krye pune vullnetare me vlefte prej 1,234876 dinaresh. Per ngritjen e Permendores se deshmoreve te Luftes Nacjonal—Clirimtare, popullli i rrethit te Gjakoves ka dhane shumen prej 75656 dinaresh.

Vlefta e pergjithshme e punes llogaaritet ne 19,056,663,50 dinaresh.

Prej seksjoneve te ndryshme te Frontit popullues jane dallue per veprimtari pune ma te persosun: seksjoni i kultures dhe i arsimit mandej ai i planit dhe i evidences.

Ne sektorin e luftimit t'analfabetizmit rrethi i Gjakoves e ka tejkalue planin e parapame. Gjate kater muejve kane mesue shkrimin e kendimin 3970 analfabete, me gjithe qe ka edhe mjaft te tjere te cilet kane mungue me rastin e provimeve, keshtu qe me paraqitjen e tyne, siguisht do te kalojne ma se 75 per qind.

Per ndertimin e shtepijave kooperative, nder te gjitha keshillat e vendeve te ketij rrethi dallohet ai i Skivjanit.

Ne baze te rezultateve dhe sukseseve te korruna nga Fronti popullues i rrethit te Gjakoves, Keshilli i Frontit Popullues te Krahines, ia dorezoi flamurin kalimtar. Rezultate te mira kane korre edhe rrethet e tjera, nder te cilet dallohet edhe ai i Gilanit, ku asht ba nji pune me vlefte prej 12.373.253 dinaresh, mandej rrethi i Podujeves etj.

Me çfare suksesesh e kremton Nji Majin Kinija popullore e Krahines s'one

Kinija popullore e Krahines s'one e edukuame me frymen e re revolucionare te shtetit t'one demokratik e kremton festen e Nji Majit me nji varg suksesesh, te cilat u mbrojne popujve t'one nji ardhmeni te lumtun. Deri me Nji Maj afer 12.000 te rij e te reja, shqiptare, serbe e malazeze kane marre pjese ne ndertimin e hekurudhes Shamac—Sarajev, ne ngritjen e fabrikes se Zheleznikut, ne ndertimin e Beogradit te ri, ne ndertimin e auto-strades „Vllazninit e Bashkimit", ne qeljen e minshteve te Rinis ne Landovice, ne ndreqjen e rruges malore Nerodimlje—Jezerce dhe ne ndertimin e hekurudhes „Obiliq—Kosovo". Ajo paraqitet me 846 salmuesa, me 13 mbajtes ordenesh pune, me 1585 antar te Rinis te lavduem ne pune, me 2815 te rije e te reja te cilet kane kalue nevojat e kursit e ndrysheme nder akcjonet e Frontit.

Per punen e vetmohueshme asht dallue ne Krahinen t'one Rinija popullore e rrethit te Gjakoves, e cila e ka fitue flamurin kalimtar si e para ne Krahin. Ajo ka dhane 101.040 dite pune me nji vlefte prej 6.912.860 dinaresh. E dyta asht klasifikue Rinija popullore e rrethit te Ferizajt.

Dekorimi i frontisave ma te mire

Per punen e tyne te vetmohueshme dhe per sakrificat e gjithanshme qe kane ba frontistat ma te mire, simbas pronozimeve t'organizatave te Frontit te rretheve e te qyteteve, jane dekorue ma se 500 antar te Frontit me medaljen e Frontit popullues te Serbis. U dekorue ata qe kane qene te paret ne çdo akcjon te Frontit dhe qe me punen e tyne kane ba te korren suksese te dukshme.

Per gjithe keta, ashtu edhe per te tjeret, dita e Nji Majit asht dite mvijeje qe detaa t'i pervishen edhe ma me hov punes se tyne per interesat e gjana te masave punonjese.

Federacjoni Botuer i Sindikatave i tkret punторet e mbarë botes per mobilizimin e fuqive per mprojtjen e paqes, liris dhe demokracis

Me rastin e kremtimit te Nji Majit, festes nderbombetare te punes, Federacjoni botuer i sindikatave ka bolue nji manifest me të cilin u drejtohet punторve te mbare botes, tue i thirre q: t'i mobilizojne fuqit e veta per mprojtjen e paqes, liris dhe demokracis. Tue e treguer rreshtimin qe i berendshet mëvetmit, ne manifest konstatohet se te gjithe popujt nuk i kane realizue qellimet per te cilat kane luftue dhe se nuk e krijoune jeten simbas interesave te tyne.

Tue brahasue gjendjen e lashtne te punторve me prolitet e palakcave te privilegjuemve le çfrytzuesve kapitalista manifesti nenvizon forcimin e organizatave demokratike dhe sindikale ne bote, çka e vertetohet vendosmenin e popujve ne luftë per pamvarsin e vertetë kombetare. Garancia e paqes se sigurte dhe te vazhdurshme qendron ne marreveshjen dhe bashkimin ne mes te shteteve fituesa.

„Tri vjet mbas fitores, thuhet mandej ne manifest, punторët konstatojne se ni shumice shtetesh shpenzojne ende shuma bolosale per buxhete ushtarake dhe armatime, ne vend qe ti perdorin per zbalimin e programeve bombetare te sigurimit shoqnuer, per rindertimin dhe per punet tjera te nevojshme publike.

Ne manifest bahet thirrje per ruejtjen dhe fitimin e te drejtave dhe lirive demokratike te popujve, per permbisimin e ni velit jetesuer te punторve, per sigurimin dhe mprojtjen e te drejtave sindikale.

Tue e thirre punторin per mprojtjen e bashkimit nderkombetar te sindikatave Federacioni botuer ven ne dukje rolin e klases punторe. e cila me punen e saje te perditshme i siguron njerzimit ciemen let bryssore per jetese, e qe asht llamurtare e çdo cirilizimi dhe berbon nga punторët qe te lene te vetedhishem per fuqit qe i perfaqesonte.

Botim i Keshillit Krahinuer të Frontit popullues: Shtypshkrojа Krahinore «PROGRES»
Pajtimet në fletore i pranon: Administrata dhe ekspeditorati.

(Vijon nga faqja e dytë)

ma të mirë për njerëzit t'onë punonjës.

Rezultatet e mbrrijtuna na tregojnë kjartazi që, po t'a çfrytzojmë eksperijencën e fitueme dhe po të përpiqemi me të gjitha fuqit për shkukjen e lëshimeve dhe të metave në punën e deritashme, do të muejmë me i krye detyrët t'ona. Na e festojmë Nji Majin e këtij vjeti me krenari për rezultatet e korruna në vjetin e kaluem, me besim dhe vendosmeni t'i përdorim të gjitha energjit t'ona për realizimin e detyreve të vjetit të dytë të Planit pesvjeçar.

Na kemi mundesi me i ba këto. Vendi i jonë asht i pamvarun nga imperjalistat e prendimit, të cilet premtojnë shum, japin fare pak e marrin shum. Na kemi aleatë të sinqertë dhe te fortë, Bashkimin e fuqishëm Sovjetik; vendet e demokracis popullore, fuqit përparimtatare dhe demokratike të vendeve ku ende qëndron zgjedha imperjaliste, e të cilat na çmojnë dhe na duen pa masë, sepse lufta dhe fitoret t'ona iu sherbejnë si shembull në luftën e t ne për liri. Na i kemi frytet e mdhaja të luftes Nacjonal — Çlirimtarë, kemi Frontin e fuqishëm popullues, pushtetin popullues. Partin, kemi shokun Tito Gëzohemi për përhallimin e vështirsive dhe që i festojme sukseset e përpjekjeve të njerëzve t'onë punonjës, e gëzojmë jetën dhe e festojmë me krenari festen e përgjithëshme popullore - Nji Majin- pse jemi hijtë e Jugosllavis së Titos. (M. Kovaçevig)